
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Operatorë Ekonomik: Vlora A. Ahmeti B.I.</b> me adresë në <b>Prishtinë</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>11.06.2026</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **09.06.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Vlora A. Ahmeti B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, nxjerr:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Vlora A. Ahmeti B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Vlora A. Ahmeti B.I.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **09.06.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **Pretendimi Nr. 1 Ankimor:**

#### **Pika Ankimore 1 – Kërkesa diskriminuuese dhe kufizim i konkurrencës**

Autoriteti Kontraktues, përmes specifikimeve teknike të përcaktuara në Aneksin 1, ka

2/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

---

vendosur kërkesa të cilat kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë operatorë të caktuar ekonomikë, në kundërshtim me nenin 1, 7, dhe 28 të LPP-së për shkak se nuk e diskriminon trajtimin e barabartë, dhe kufizon konkurrencës efektive.

Konkretisht, kërkesat si:

kapacitet operativ minimal i dokumentuar prej 90 ha/ditë;  
disponueshmëria e minimum 2 njësisive rezervë UAS;  
sistemi radarik për shmangie pengesash;  
plan zëvendësimi brenda 24 orëve;  
disponueshmëria 7 ditë në javë me afat reagimi 24–48 orë;

nuk janë argumentuar me nevojat reale të kontratës dhe tejkalojnë kërkesat minimale të nevojshme për realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Këto kërkesa përjashtojnë operatorë ekonomikë të licencuar dhe të kualifikuar që posedojnë pajisje profesionale dhe përvojë adekuate në trajtimin e kulturave bujqësore me dron, por që nuk disponojnë numrin e pajisjeve rezervë ose kapacitetin e kërkuar ditor. Për pasojë, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë disproporcionale dhe kufizuese, duke cenuar konkurrencën e lirë dhe duke reduktuar numrin e operatorëve ekonomikë potencialisht të përgjegjshëm.

Duke u bazuar sa më lartë kërkojm që keto kërkesa të korigjohen dhe ndryshohen.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:**

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuuese kemi pranuar këtë përgjigje:

#### **Lidhur me pretendimin për kërkesa diskriminuuese dhe kufizim të konkurrencës**

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin se kriteret teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë diskriminuuese ose të hartuara për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë.

Kriteret si kapaciteti operativ ditor, sistemi radarik për shmangie të pengesave, bateritë rezervë, sistemi i karikimit në terren, reagimi brenda afatit të caktuar dhe plani i zëvendësimit në rast defekti janë të

lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i cili është realizimi i shërbimit të spërkatjes së kulturave bujqësore me dronë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Ky aktivitet nuk është shërbim i thjeshtë administrativ, por shërbim sezonal dhe operativ në terren, ku vonesat, defektet teknike, mungesa e pajisjeve rezervë ose pamundësia për reagim në kohë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e trajtimit, mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe interesin publik të fermerëve përfitues.

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesat teknike nuk janë vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar që operatori ekonomik fitues të ketë kapacitet real teknik dhe operativ për realizimin e kontratës. Në Aneksin 1 kërkohet, ndër të tjera, kapacitet minimal prej 90 ha/ditë në kushte standarde, sistem radarik për shmangie të pengesave, raportim digjital, bateri rezervë, karikim në terren, reagim brenda 24–48 orëve dhe raportim për çdo operim.

Në veçanti, sistemi radarik për shmangie të pengesave është kërkesë e arsyeshme për operate në zona rurale ku mund të ketë pemë, shtylla, rrjete elektrike, objekte, terren të pabarabartë dhe pengesa të tjera. Kjo kërkesë lidhet me sigurinë e operimit, mbrojtjen e pajisjes, mbrojtjen e pronës dhe shmangien e dëmeve në terren.

Sa i përket kapacitetit rezervë UAS, Autoriteti Kontraktues sqaron se qëllimi nuk është që të kërkohen pajisje të tepërta, por të sigurohet vazhdimësia e punës. Kërkesa duhet të kuptohet si nevojë për minimum dy pajisje UAS në dispozicion: një pajisje për operim dhe një pajisje në gjendje gatishmërie për zëvendësim në rast defekti, në mënyrë që shërbimi të mos ndërpritet.

Në rastin konkret, shërbimi ka të bëjë me spërkatjen e kulturave bujqësore, përfshirë trajtimin kundër cikadës së rrushit. Ky trajtim nuk është shërbim i zakonshëm që mund të realizohet në çdo kohë pa ndikim në rezultat. Përkundrazi, trajtimi kundër cikadës ka karakter sezonal dhe duhet të kryhet brenda afatit të caktuar kohor, në periudhën kur ndërhyrja ka efektin e synuar.

Nëse trajtimi realizohet me vonesë ose zgjatet përtej periudhës së përshtatshme, efekti i spërkatjes mund të zvogëlohet ndjeshëm ose të mos arrihet qëllimi për të cilin është planifikuar shërbimi. Për këtë arsye, kapaciteti operativ, reagimi i shpejtë, disponueshmëria e pajisjeve dhe vazhdimësia e punës janë elemente thelbësore të kontratës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesat janë të arsyeshme, proporcionale dhe të lidhura me objektin e kontratës. Pretendimi për diskriminim dhe kufizim të konkurrencës nuk qëndron.

## **Pretendimi Nr. 2 Ankimor:**

### **Pika Ankimore 2 – Specifikimet teknike nuk mundësojnë realizimin e plotë të projektit sipas kushteve reale në terren**

Autoriteti Kontraktues ka paraparë trajtimin e rreth 1,500 hektarëve vreshta, së bashku me identifikimin e parcelave, regjistrimin e koordinatave GPS, monitorimin pas trajtimit dhe raportimin teknik.

Megjithatë, specifikimi teknik që kërkon kapacitet minimal prej 90 hektarë në ditë nuk merr parasysh kushtet reale operative në terren, si:

fragmentimin e parcelave të vreshtave;  
distanca ndërmjet parcelave;  
mbushjen e rezervuarëve dhe ndërrimin e baterive;  
kushtet meteorologjike dhe kufizimet e fluturimit;  
procedurat e sigurisë dhe koordinimin me fermerët për secilën parcelë.

Për më tepër, kontrata përfshin edhe aktivitete shtesë si identifikimi i parcelave, hartëzimi, monitorimi pas trajtimit dhe raportimi teknik, të cilat kërkojnë angazhim të konsiderueshëm kohor dhe njerëzor. Për këtë arsye, kapaciteti i kërkuar ditor nuk është në përputhje me metodologjinë reale të realizimit të projektit dhe krijon mospërputhje ndërmjet kërkesave teknike dhe shërbimeve të kontraktuara.

Si rezultat, specifikimet aktuale nuk garantojnë realizim të qëndrueshëm dhe profesional të të gjitha aktiviteteve të parapara në kontratë, por përkundrazi krijojnë kushte artificiale që favorizojnë operatorë të caktuar ekonomikë dhe nuk reflektojnë realitetin e operimeve

të trajtimit me dron në terren.

Andaj duke u bazuar sa më lartë kërkojm që keto kërkesa të korigjohen dhe ndryshohen.

## **Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:**

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

### **Lidhur me pretendimin se kapaciteti 90 ha/ditë nuk merr parasysh kushtet reale në terren**

Autoriteti Kontraktues sqaron se kërkesa për kapacitet operativ minimal prej 90 ha/ditë është përcaktuar si kapacitet në kushte standarde operative, dhe jo si detyrim absolut që çdo ditë, në çdo rrethanë dhe pa marrë parasysh kushtet në terren, të realizohet e njëjta sipërfaqe.

Autoriteti Kontraktues është i vetëdijshëm se realizimi i shërbimit në terren mund të ndikohet nga disa faktorë objektivë, si kushtet atmosferike, shpejtësia e erës, konfigurimi i parcelave, distancat ndërmjet lokacioneve, qasja në terren, furnizimi me ujë/tretësirë, ndërrimi i baterive dhe koordinimi me fermerët përfitues. Megjithatë, këta faktorë nuk e bëjnë kriterin të paarsyeshëm, por përkundrazi tregojnë pse kërkohet që operatori ekonomik të ketë kapacitet të mjaftueshëm teknik, logjistik dhe organizativ.

Kërkesa për 90 ha/ditë nuk është vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar që operatori ekonomik fitues të jetë në gjendje të mobilizohet shpejt dhe të realizojë shërbimin brenda periudhës së nevojshme agronomike. Trajtimi kundër cikadës së rrushit është trajtim sezonal dhe efektiviteti i tij

lidhet drejtpërdrejt me kohën e aplikimit. Nëse spërkatja zgjatet përtej periudhës kur duhet të realizohet, efekti i trajtimit mund të zvogëlohet ndjeshëm ose të mos arrihet qëllimi për të cilin është planifikuar shërbimi.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka vendosur kapacitetin operativ ditor si kriter funksional për të garantuar që shërbimi të mund të kryhet në kohë. Mënyra se si operatori ekonomik e arrin këtë kapacitet mbetet përgjegjësi e tij. Operatori mund ta realizojë këtë përmes numrit të pajisjeve UAS në dispozicion, organizimit të ekipit, baterive rezervë, sistemit të karikimit në terren, furnizimit të shpejtë me tretësirë, planifikimit paraprak të parcelave dhe menaxhimit efikas të operimeve ditore.

Autoriteti Kontraktues nuk e përcakton një metodë të vetme të realizimit të këtij kapaciteti. Kërket vetëm që operatori ekonomik të dëshmojë se ka kapacitet real për ta përmbushur këtë kërkesë në kushte standarde pune.

Po ashtu, kontrata është kontratë publike kornizë dhe realizimi i shërbimeve do të bëhet përmes urdhër-berjeve, sipas nevojave reale të Autoritetit Kontraktues. Kjo do të thotë se realizimi konkret do të planifikohet sipas kërkesave në terren, kushteve atmosferike dhe periudhës së përshtatshme për trajtim.

Prandaj, pretendimi se kriteri prej 90 ha/ditë është i paarsyeshëm nuk qëndron. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, me nevojën për trajtim brenda afatit të përshtatshëm kohor dhe me sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm për realizimin efektiv të shërbimit.

### **Pretendimi Nr. 3 Ankimor:**

#### **Pika Ankimore 3 – Kërkesat teknike janë joproporcionale me objektin e kontratës dhe nuk janë të arsyetuara**

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një sërë kërkesash teknike dhe operative, si: sistem radarik për shmangie pengesash, disponueshmëri të minimum 2 njësive rezervë UAS, kapacitet minimal të garantuar ditor, disponueshmëri 7 ditë në javë, plan zëvendësimi brenda 24 orëve, si dhe kërkesa të avancuara për raportim dhe arkivim të të dhënave.

Megjithatë, në dosjen e tenderit nuk është paraqitur asnjë arsyetim teknik apo analizë që dëshmon nevojën e këtyre kërkesave në raport me natyrën e kontratës. Objekti i kontratës është trajtimi i vreshtave kundër cikadës së hardhisë, ndërsa kërkesat e lartcekura tejkalojnë nevojat reale të shërbimit dhe nuk ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e trajtimit fitosanitar.

Për rrjedhojë, këto kërkesa janë joproporcionale me objektin e kontratës dhe krijojnë barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të licencuar dhe profesionalisht të aftë për realizimin e shërbimit.

Andaj duke u bazuar sa më lartë kërkojmë që këto kërkesa të korrigjohen dhe ndryshohen.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:**

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

#### **Lidhur me pretendimin se kërkesat teknike janë joproporcionale dhe të paarsyetuara**

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin se kërkesat teknike janë joproporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesat e përcaktuara në dosje janë vendosur duke marrë parasysh natyrën e shërbimit, nevojën për trajtim në kohë, sigurinë e operimit me UAS, vazhdimësinë operative dhe nevojën për raportim të dokumentuar. Parashtruesi i kërkesës konteston elemente si sistemi radarik, kapaciteti minimal ditor, disponueshmëria sezonale, zëvendësimi në rast defekti, raportimi dhe arkivimi i të dhënave. Këto elemente janë pjesë normale e një shërbimi profesional me dronë bujqësorë dhe lidhen drejtpërdrejt me cilësinë, sigurinë dhe kontrollin e realizimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues thekson se objekti i kontratës nuk është vetëm “hedhja e preparatit”, por realizimi i një shërbimi të plotë në terren, i cili përfshin planifikimin, identifikimin e sipërfaqes, zbatimin e trajtimit, raportimin teknik dhe ruajtjen e të dhënave për qëllime kontrolli dhe auditimi. Dosja e tenderit kërkon përdorim të sistemit hartografik për identifikim të parcelave, raport me koordinata dhe arkivim digjital të të dhënave për auditim.

Pretendimi se këto kërkesa nuk ndikojnë në cilësinë e trajtimit fitosanitar është i pjesshëm dhe nuk merr parasysh aspektin operacional dhe të sigurisë. Një trajtim fitosanitar me dron nuk vlerësohet vetëm nga preparati që aplikohet, por edhe nga saktësia e aplikimit, koha e reagimit, mbulimi i sipërfaqes, siguria e fluturimit, gjurmueshmëria e punës dhe dokumentimi i shërbimit të realizuar.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues konsideron se kriteret janë të lidhura me objektin e kontratës dhe janë të arsyetuara nga nevoja për shërbim profesional, të sigurt dhe të verifikueshëm. Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

#### **Pretendimi Nr. 4 Ankimor:**

##### **Pika Ankimore 4 – Mungesë e qartësisë dhe paqartësi në përcaktimin e kapaciteteve dhe sasive të kontratës**

Dosja e tenderit përmban paqartësi lidhur me vëllimin real të shërbimeve që kërkohen nga operatori ekonomik.

Nga njëra anë janë paraparë 750 hektarë për identifikim të parcelave dhe regjistrim të koordinatave, ndërsa nga ana tjetër janë paraparë 1,500 hektarë për trajtim dhe 1,500 hektarë për monitorim pas trajtimit. Po ashtu është përcaktuar se sasitë janë vetëm indikative me devijim të lejuar  $\pm 30\%$ .

Këto të dhëna nuk sqarojnë:

numrin e pritshëm të trajtimeve për parcelë;  
sipërfaqen reale që do të trajtohet gjatë periudhës së kontratës;  
numrin e cikleve të monitorimit;  
ngarkesën reale operative dhe logjistike të operatorit ekonomik.

Paqartësitë e tilla e bëjnë të pamundur përgatitjen e një oferte të saktë financiare dhe

4/3

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

---

teknike nga operatorët ekonomikë, duke cenuar parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë dhe harmonizojë specifikimet teknike dhe sasitë e parapara, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të përgatisin oferta të krahasueshme dhe të bazuara në të dhëna të qarta.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 4 Ankimor:**

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

#### **Lidhur me qartësinë e sasive dhe kapaciteteve të kontratës**

Autoriteti Kontraktues merr parasysh pretendimin e Operatorit Ekonomik lidhur me nevojën për qartësi më të madhe në interpretimin e sipërfaqeve dhe sasive të kontratës. Parashtruesi pretendon se në dokumentacion paraqiten 750 ha për identifikim/koordinata, 1,500 ha për trajtim dhe monitorim, si dhe devijim i lejuar  $\pm 30\%$ , gjë që sipas tij krijon paqartësi në përlllogaritjen e ofertës.

Autoriteti Kontraktues sqaron se për qëllime të këtij aktiviteti të prokurimit, sipërfaqja e kontraktuar për realizimin e shërbimit është 750 ha. Kjo sipërfaqe përbën bazën mbi të cilën duhet të përgatitet oferta dhe duhet të interpretohen aktivitetet përcjellëse të shërbimit.

Shërbimet si identifikimi i parcelave, regjistrimi i koordinatave, monitorimi pas trajtimit dhe raportimi teknik janë të lidhura me sipërfaqen që trajtohet dhe kanë për qëllim dokumentimin, kontrollin dhe pranimin e shërbimit të spërkatjes. Ato nuk duhet të interpretohen si fushëveprime të ndara që e ndryshojnë objektin kryesor të kontratës.

Autoriteti Kontraktues sqaron se njësia matëse për shërbimin është hektari (ha), ndërsa përlllogaritja e ofertës duhet të bëhet mbi bazën e sipërfaqes kontraktuale prej 750 ha. Për çdo sipërfaqe të trajtuar kërkohet raportim teknik përkatës, në mënyrë që të dokumentohet data, lokacioni, sipërfaqja e trajtuar, parametrat bazë të operimit dhe kushtet përkatëse të realizimit.

Ky sqarim nuk ndryshon objektin e kontratës, por qartëson fushëveprimin, mënyrën e përlllogaritjes dhe raportimin e shërbimit për të gjithë Operatorët Ekonomikë. Autoriteti Kontraktues vlerëson se ky qartësim është i mjaftueshëm për të eliminuar çdo paqartësi në interpretimin e paramasës dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

### **Pretendimi Nr. 5 Ankimor:**

#### **Pika Ankimore 5 – Mungesa e kërkesës për Certifikatë të TVSH-së cenon përshtatshmërinë profesionale të operatorëve ekonomikë**

Autoriteti Kontraktues në kriteret e përshtatshmërisë profesionale ka kërkuar vetëm Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit, ndërsa nuk ka kërkuar Certifikatën e TVSH-së për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Duke pasur parasysh se vlera e parashikuar e kontratës është rreth 50,000.00 Euro, realizimi i një kontrate të tillë kërkon kapacitete reale operative dhe financiare. Sipas legjislacionit tatimor në fuqi, operatorët ekonomikë që realizojnë qarkullim mbi pragun ligjor janë të obliguar të regjistrohen si deklarues të TVSH-së.

Mosparashikimi i kësaj kërkesë krijon mundësinë që në procedurë të marrin pjesë operatorë ekonomikë pa kapacitet të dëshmuar ekonomik dhe pa përvojë të mjaftueshme tregtare për realizimin e kontratës, duke cenuar parimin e konkurrencës së drejtë dhe trajtimin të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të plotësojë kriteret e përshtatshmërisë profesionale duke kërkuar edhe Certifikatën e TVSH-së si dëshmi të aktivitetit ekonomik dhe kapacitetit minimal të operatorëve ekonomikë.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 5 Ankimor:**

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

#### **Lidhur me pretendimin për mungesën e kërkesës për Certifikatë të TVSH-së**

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me pretendimin se mungesa e kërkesës për Certifikatë të TVSH-së cenon përshtatshmërinë profesionale të operatorëve ekonomikë.

Kriteret e përshtatshmërisë profesionale janë përcaktuar në përputhje me natyrën e kontratës dhe kanë për qëllim të dëshmojnë se Operatori Ekonomik është i regjistruar për veprimtari relevante. Në njoftim kërkohet regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional/komercial ose regjistrin e ndërmarrjeve, me veprimtari të deklaruar në shërbime bujqësore dhe/ose operime me mjete ajrore pa pilot, ndërsa dëshmia e kërkuar është certifikata e regjistrimit të biznesit së bashku me informatat e biznesit.

Certifikata e TVSH-së nuk është kriter profesional për të dëshmuar aftësinë teknike për spërkatje me dronë, as nuk dëshmon domosdoshmërisht përvojë, kapacitet teknik, pajisje, personel apo aftësi për realizimin e shërbimit. Regjistrimi në TVSH lidhet me statusin tatimor dhe qarkullimin e operatorit, jo me aftësinë profesionale për ekzekutimin e shërbimit.

Për më tepër, vendosja e Certifikatës së TVSH-së si kriter i detyrueshëm mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të rinj ose operatorëve që mund të kenë kapacitete teknike dhe profesionale për realizimin e shërbimit, por që nuk janë të regjistruar në TVSH në momentin e ofertimit. Një kërkesë e tillë do të mund të krijonte kufizim të panevojshëm të konkurrencës pa lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues sqaron se përmbushja e obligimeve tatimore kontrollohet përmes mekanizmave dhe dokumenteve përkatëse të përshtatshmërisë në fazat e parapara të procedurës, por nuk është e nevojshme që Certifikata e TVSH-së të vendoset si kriter profesional në këtë aktivitet.

Prandaj, kërkesa për shtimin e Certifikatës së TVSH-së si kriter i detyrueshëm refuzohet si e pabazuar dhe joproporcionale me objektin e kontratës.

## **Pretendimi Nr. 6 Ankimor:**

### **Pika Ankimore 6 – Mungesa e kërkesës për staf profesional për realizimin e kontratës**

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraparë asnjë kriter lidhur me stafin profesional që duhet të angazhohet për realizimin e projektit, pavarësisht se kontrata përfshin identifikimin e parcelave, hartëzimin, trajtimin fitosanitar me dron, monitorimin pas trajtimit dhe raportimin teknik.

Realizimi i këtyre aktiviteteve kërkon angazhimin e personelit profesional, si:  
pilotë të licencuar të UAS;

5/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

---

operatorë teknikë në terren;  
personel për hartëzim dhe menaxhim të të dhënave GPS;  
ekspertë agronomie ose personel me përvojë në mbrojtjen e bimëve.

Mosvendosja e kriterëve minimale për personelin profesional krijon rrezik serioz për realizimin jo cilësor të kontratës dhe nuk garanton se operatori ekonomik fitues do të disponojë resurset njerëzore të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të kërkuara.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë numrin minimal dhe kualifikimet profesionale të stafit që duhet të angazhohet për realizimin e kontratës.

## **Përgjigje në Pretendimi Nr. 6 Ankimor:**

Ne baze te Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

### **Lidhur me pretendimin për mungesë të kërkesës për staf profesional**

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet plotësisht me pretendimin se dosja e tenderit nuk garanton angazhimin e personelit të nevojshëm profesional.

Në Aneksin 1 është kërkuar që piloti i angazhuar të posedojë certifikatë A4 dhe autorizim për operime sipas kërkesave të AAC për kategori specifike. Po ashtu, janë kërkuar procedura sigurie, protokoll emergjence, metodologji për kalibrim të dozës për hektar dhe plan sezonal operativ për territorin e komunës. Këto kërkesa dëshmojnë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur standarde minimale për realizim profesional dhe të sigurt të shërbimit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues sqaron se nuk është e nevojshme të vendosen kriterë të tepërta për numrin dhe profilet e stafit në mënyrë që të mos krijohen kufizime të panevojshme për konkurrencën. Objekti i kontratës është shërbim i spërkatjes me dronë dhe jo shërbim i veçantë i konsulencës agronomike, rilevimit gjeodezik, hartëzimit profesional apo analizës shkencore të kulturave bujqësore.

Aktivitetet si identifikimi i parcelës, koordinatat, raportimi dhe monitorimi janë pjesë mbështetëse të shërbimit të spërkatjes dhe mund të realizohen nga ekipi operativ i operatorit ekonomik, për aq kohë sa operatori dëshmon kapacitetin teknik dhe respektimin e kërkesave të dosjes.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të kërkonte ekspertë të veçantë agronomie, gjeodezie, GIS, topografie apo analizë profesionale fitosanitare, atëherë këto kërkesa do të duhej të specifikoheshin si shërbime të veçanta. Për këtë aktivitet, kërkesa thelbësore është që shërbimi të kryhet nga operatori/pilot i autorizuar për UAS dhe që operatori ekonomik të ketë pajisjet, procedurat dhe kapacitetin për raportim dhe realizim të sigurt.

Për këtë arsye, pretendimi që mungesa e një liste të detajuar të stafit e bën tenderin të papërshtatshëm nuk qëndron. Megjithatë, për qëllime qartësimi, Autoriteti Kontraktues mund të saktësojë se operatori ekonomik duhet të angazhojë personel të mjaftueshëm teknik dhe operativ për realizimin e shërbimit, duke përfshirë së paku pilotin/operatorin e certifikuar UAS dhe personelin ndihmës në terren sipas nevojës.

### **Pretendimi Nr. 7 Ankimor:**

#### **Pika Ankimore 7 – Mungesa e kërkesave për kapacitet ekonomik, financiar dhe pajisje mbështetëse për realizimin e kontratës**

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar asnjë dëshmi për kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, si dhe nuk ka përcaktuar kërkesa minimale për pajisjet mbështetëse të nevojshme për realizimin e projektit.

Duke marrë parasysh natyrën e kontratës dhe sipërfaqen prej rreth 1,500 hektarësh që duhet të trajtohet, realizimi i projektit kërkon domosdoshmërisht:

automjete për transportin e dronëve, baterive dhe stafit;  
rezervuarë për përgatitjen dhe ruajtjen e preparateve;  
sisteme për furnizim me ujë në terren;  
gjeneratorë ose sisteme karikimi për bateritë;  
pajisje ndihmëse për operime në terren.

Po ashtu, legjislacioni i prokurimit publik parasheh që Autoriteti Kontraktues mund dhe duhet të kërkojë kapacitete ekonomike, financiare dhe teknike proporcionale me objektin e kontratës, në mënyrë që të sigurohet realizimi i suksesshëm i saj.

Mosparashikimi i këtyre kërkesave krijon rrezik që kontrata t'i jepet një operatori ekonomik pa kapacitetet reale për realizimin e projektit, duke rrezikuar zbatimin e kontratës dhe interesin publik.

Për këtë arsye kërkojmë që dosja e tenderit të plotësohet me kritere minimale për kapacitetin ekonomik, financiar dhe teknik, si dhe me kërkesa konkrete për pajisjet mbështetëse të nevojshme për realizimin e projektit.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 6 Ankimor:**

Ne baze të Konsultimeve, nga Njësia Kërkuese kemi pranuar këtë përgjigje:

#### **Lidhur me pretendimin për mungesë të kërkesave për kapacitet ekonomik, financiar dhe pajisje mbështetëse**

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik, sqaron se nuk qëndron pretendimi se Dosja e Tenderit nuk siguron kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesa teknike dhe operative që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës, përfshirë pajisjen UAS për spërkatje bujqësore, kapacitetin operativ ditor, bateritë rezervë, sistemin e karikimit në terren, raportimin teknik, planin sezonal operativ, procedurat e sigurisë, protokollin emergjent dhe metodologjinë për kalibrimin e dozës për hektar. Këto kërkesa kanë për qëllim të dëshmojnë se Operatori Ekonomik ka kapacitet real teknik dhe organizativ për realizimin e shërbimit.

Sa i përket kapacitetit ekonomik dhe financiar, Autoriteti Kontraktues sqaron se vendosja e kriterëve të tilla nuk është e domosdoshme në çdo aktivitet të prokurimit. Kriteret ekonomike dhe financiare vendosen vetëm kur janë të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Në rastin konkret, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë për shërbim, me realizim përmes urdhërblërjeve dhe pagesa sipas sasive realisht të kryera, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se kërkesat kryesore duhet të fokusohen në kapacitetin teknik, operativ dhe profesional të Operatorit Ekonomik.

Vendosja e kriterëve të panevojshme financiare, si qarkullim minimal, balance financiare apo dëshmi të ngjashme, pa një lidhje të domosdoshme me objektin e kontratës, do të mund të krijonte kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe të përjashtonte operatorë ekonomikë që kanë kapacitet real teknik për kryerjen e shërbimit.

Lidhur me pajisjet mbështetëse, Autoriteti Kontraktues sqaron se mjetet si automjetet për transport, rezervuarët, sistemet e furnizimit me ujë, gjeneratorët, karikuesit, pajisjet ndihmëse dhe logjistika në terren janë pjesë e organizimit të brendshëm operacional të Operatorit Ekonomik. Mënyra se si Operatori Ekonomik organizon transportin, furnizimin me ujë, përgatitjen e tretësirës, karikimin e baterive dhe mbështetjen në terren mbetet përgjegjësi e tij, përderisa ai përmbush kërkesat teknike dhe operative të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk e sheh të arsyeshme të përcaktojë në mënyrë të detajuar llojin, numrin apo modelin e çdo pajisjeje mbështetëse, pasi një gjë e tillë do të ndërhynte në mënyrën e organizimit të Operatorit Ekonomik dhe mund të krijonte kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Operatorë të ndryshëm mund ta realizojnë të njëjtin shërbim me organizime të ndryshme operative, përmes automjeteve, rezervuarëve, pompave, gjeneratorëve, karikuesve apo pajisjeve të tjera të përshtatshme, pa qenë e nevojshme që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë paraprakisht çdo mjet mbështetës.

Ajo që është thelbësore për Autoritetin Kontraktues është rezultati i shërbimit: realizimi i spërkatjes në sipërfaqen e kërkuar, brenda afateve të nevojshme, me pajisje të përshtatshme UAS, me operatorë të autorizuar, me raportim teknik dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë. Për këtë arsye, Dosja e Tenderit ka vendosur kërkesa që lidhen drejtpërdrejt me kapacitetin për realizimin e shërbimit, duke mos e ngarkuar procedurën me kritere të tepërta që nuk janë domosdoshmërisht të nevojshme për vlerësimin e ofertave.

Autoriteti Kontraktues thekson se Operatori Ekonomik fitues do të jetë përgjegjës për sigurimin e të gjitha pajisjeve, mjeteve, stafit dhe logjistikës së nevojshme për realizimin e kontratës. Nëse gjatë zbatimit të kontratës Operatori Ekonomik nuk arrin të realizojë shërbimin sipas kushteve të përcaktuara,

atëherë ndaj tij mund të zbatohen mekanizmat kontraktualë përkatës, përfshirë përgjegjësinë për mospërbushje të kontratës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pretendimi është i pabazuar. Dosja e Tenderit përmban kërkesa të mjaftueshme teknike dhe operative për të siguruar realizimin e kontratës, ndërsa mënyra konkrete e sigurimit të pajisjeve mbështetëse dhe organizimit logjistik në terren mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik. Vendosija e kriterëve shtesë financiare dhe e listave të detajuara për pajisje mbështetëse do të ishte joproporcionale dhe mund të kufizonte konkurrencën pa qenë e domosdoshme për objektin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues kërkon kapacitetin dhe rezultatin e shërbimit, jo mënyrën e brendshme se si OE e organizon çdo mjet mbështetës në terren.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>